





**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc në “Studime Psikosociale”**  
**Ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof. As. Artemisi Shehu
2. Dr. Silvana Loka

(Korrik/2019)





**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc në “Studime Psikosociale”**

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Nr. 409, datë 27.07.2016
4	Titulli i programit të studimit:	Studime Psikosociale
5	Cikli i studimit:	I parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme)	Kohe të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
15	Numri i Studenteve	109






## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Studime Psikosociale”**

Programi është licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr. 409, datë 27.07.2016 bazuar mbi Vendimin e Këshillit të Akreditimit, Nr. 173, datë 07.07.2016 “Mbi hapjen e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Studime Psikosociale”, të Shkollës së lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë. Ky vlerësim bëhet në kuadër të akreditimit të parë të këtij programi.

Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale”, është licensuar të ofrohet si një program: me kohë të plotë; me kohëzgjatje prej 3 vite/6 semestra; me 180 kredite (ECTS); me një numër të parashikuar prej 50 studentë; me nivelin 6 të diplomës sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në gjuhën shqipe. Ky program studimi i përket fushave të studimit të shkencave sociale dhe filologjike.

Vendimi i Këshillit të Akreditimit (i sipërcituar) vlerësoi se programi i studimit i përbushte plotësisht standardet e cilësisë, duke i dhënë vlerësim pozitiv dhe rekomandoi Ministrin e Arsimit dhe Sportit hapjen e këtij programi (vendimi i cituar më sipër).

Fillimisht programi i studimit Bachelor në “studime Psikosociale” është ofruar nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, por me Vendim Senati, nr.6/1, datë 2017-05-19, ky program kaloi në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, në Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë.

Shkolla e lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë është hapur me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit "Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë" dhe i është dhënë akreditimi institucional përmes UMASH Nr. 124, datë 29.03.2012 “Akreditim Institucional dhe të programeve të studimit (3 programe Bachelor)”.

Me Urdhrin Nr. 201 datë 28.05.2013 është kryer riorganizimi i njësisë kryesore "Fakulteti i shkencave ekonomike", "Fakulteti i shkencave politike" dhe "Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike" në insitucionin "Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqiperisë".

Me Urdhër 278, datë 19.05.2017 të MAS është miratuar statuti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 105, datë 10.11.2017 ka miratuar akreditimin periodik institucional si Shkollë e Lartë Private. Me një vendim të mëvonshëm të Bordit të Akreditimit Nr. 43, datë 13.07.2018 është miratuar akreditimi institucional si Universitet. Ky vlerësim është kërkuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në shkresën “Kthim përgjigje”, Nr. 918/2, datë 20.06.2018 për akreditimin për herë të parë.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Artemisi Shehu dhe Dr. Silvana Loka, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Draft-Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 25.06.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.131/18 prot. Datë 25.06.2019. Institucioni ka sjellë me anë të shkresës nr. 849/1 prot. Datë 27.06.2019, komentet mbi draft raportin.

GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:



**-Për komentin:** Sikurse evidentohet nga ekspertet, ky program me Vendimin te Keshillit te Akreditimit, Nr. 173, date 07.07.2016 "Mbi hapjen e programit te studimit te ciklit te pare, Bachelor ne "Studime Psikosociale", te Shkolles se larte Private Mesdhetare te Shqiperise, eshte vleresuar se i ka permbushur plotesisht standardet e cilesise, duke i dhene vleresim pozitiv dhe duke rekomanduar Ministrin e Arsimit dhe Sportit per hapjen e tij. Ne kete kuader, ne kemi respektuar dhe i kemi qendruar idese qe ne hapje te programit dhe gjate ketyre tre viteve, te gjitha ndryshimet per permiresirnin e programit jane realizuar brenda hapesirave qe lejon ligji dhe aktet e tij nenligjore, duke garantuar strukturen kurrikulare te programit te studimit.

Urdhri i Psikologut te Shqiperise ka ndjekur etapat te ndryshme per ngritjen dhe institucionalizimit e tij. Qe nga koha e ngritjes se komisionit te perkohshem per organizimin e zgjedhjeve te para, me Urdher nr. 2017 i dates 03.10.2016 e deri ne shkurt te 2017, pas kesaj periudhe e ne vazhdim Urdhri ka proceduar me themelimin e statutit te tij si edhe me ndryshime nder te cilat, te fundit i referohen daten 27.07.2018. Nderkohe, programi i studimit Bachelor ne Studime Psikosociale eshte licencuar me Urdher te Ministrit te Arsimit, Nr, 409, date 27.07.2016 dhe ka filluar aktivitetin ne vitin akademik 2016-2017. Ligji i Arsimit te Larte perben shtratin juridik mbi te cilin mbeshket aktiviteti i institucioneve te arsimit te larte, ku ne kete ligj, neni 74, pika b, jane parashikuar dhe jane percaktuar te gjitha ato fusha ku programet e studimit duhet te jene programe studimi te integruara 5 vjecare sic jane mjekesia, drejtesia, stomatologjia, farmacia, veterinaria dhe arkitektura, por ne asnje nga percaktimet e ligjit, nuk parashikohet qe studimet ne fushen e psikologjise te jene te kesaj natyre sikurse eshte parashikuar nga Urdhri i Psikologut te Shqiperise.

Por, edhe duke ju referuar Statutit te Urdhrit te Psikologut, k.reu II, neni 8, pika 1/b ... Anetaret e Urdhrit te Psikologut ne Republiken e Shqiperise duhet te kene diplomen e studimeve te larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" ne psikologji ose ekuivalent me te, sipas legjislacionit ne fuqi per arsimin e larte, leshuar nga institucioni i arsimit te larte, brenda apo jashte vendit, te njohura nga ministria pergjegjese per arsimin....

Sa me siper, si edhe eshte evidentuar nga GVJ ne faqen 5 dhe 6 te RVJ, programi i studimit Programi i studimit Bachelor ne "Studime Psikosociale" eshte hartuar per ta pajisur studentin me njohuri dhe aftesi te pershtatshme me profilin perkates dhe ka si objektiv formimin e shprehive edhe te profesionit te psikologut, cka eshte ne perputhje me kriterin e kerkuar per anetaresimin ne Urdhrin e Psikologut. Ne lidhje me cka evidentohet ne RVJ per licensimin, ne vleresojme se jane lendet e curricules te programit te studimit si te ciklit te pare dhe ato te ciklit te dyte ne UMSH, qe pletesojne kriterin per anetaresim dhe nga kjo premise ne jemi ne bisedime me Urdhrin dhe institucionet e tjera pergjegjese.

GVJ mirëpriti komentet e dërguara nga institucioni UMSH lidhur me objeksionin e tyre për standardin e parë. Jemi shumë të ndërgjegjshëm për mënyrën se si procesi i licensimit të këtij programi studimi ka proceduar dhe ndodhur, por sërish i mbetemi mendimit se në formën dhe mënyrën si ky program studimi është i ndërtuar nuk mund të jetë një program studimi Bachelor që ofrohet vetëm në Psikologji, dhe kjo jo vetëm për arsyen e titullit të Diplomës Bachelor, që studentët e diplomuar prej këtij programi do të marrin, por mbi të gjitha edhe për shkak të kurrikulës që ky program përmban, duke qenë se ai thekson edhe aspektin sociologjik në përmbajtje të tij çka e specializon dashje pa dashje më shumë studentin në drejtimin sociologjik se atë të përgjithshëm në psikologji. Ndaj, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**-Për komentin:** Sikurse evidentohet nga ekspertet, ky program me Vendimin te Keshillit te Akreditimit, Nr. 173, date 07.07.2016 "Mbi hapjen e programit te studimit te ciklit te pare, Bachelor ne "Studime Psikosociale", te Shkolles se larte Private Mesdhetare te Shqiperise, eshte vleresuar se i ka permbushur plotesisht standardet e cilesise, duke i dhene vleresim pozitiv dhe duke rekomanduar Ministrin e



*Arsimit dhe Sportit per hapjen e tij me te gjithë elementet karakterizues dhe specifiken e tij, per te plotesuar ate pjese te nevojës qe ka tregu me specialiste te cilet tejkalojne njohurite baze ne fushen e psikologjise, duke i pasuruar ato me njohuri te tjera te fushave sociale. Ky program studimi eshte nje risi ne tregun e dijes ne Shqiperi dhe ende ndesh veshtiresi ne perceptim nga kendveshtrirni klasik i Psikologjise apo Sociologjise. Sa me siper, programi i studimit Bachelor ne Studimet Psikosociale ka ne permbajtje te strukturese se tij kurrikulare lende me fokus ne psikologji dhe pasurohet me njohuri te tjera te shkencave sociale, per t'i ofruar tregut, si per sektorin publik edhe per ate privat, specialistin e pershtatshem per sherbimet psikosociale, te cilat me se shumti aktualisht mbulohen nga psikologe ose punonjes sociale. Permendim ketu "Sherbimi Psiko-social ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza", spitale dhe qendra te tjera te sistemit spitalor, sherbimin psikosocial dhe te shendetit mendor te Ministrise se Shendetesise, sherbimet psikosociale qe ofrojne bashkite, si dhe shume institucione e organizata te tjera, te cilet kane nevojë per specialiste psikosociale. Natyrisht termi psikosocial nuk e perjashton psikologjine, perkundrazi, i jep vlere dhe e konsideron ate nje sektor te rendesishern ku ky program i bashkengjit kompetencat plotesuese nga shkencat e tjera sociale.*

GVJ sërish mirëkupton objeksionin e institucionit mbi komentin e GVJ mbi mospërputhshmërinë mes objektivave të programit dhe produktit që ai nxjerr me titullin përkatës të studentit Studime Psikosociale. Por GVJ i mbetet argumenteve të paraqitura dhe të bëra edhe në pikën e parë të standardit lidhur me këtë mospërputhje. Emërtimi i mbajtjes së titullit që studenti do të marrë pas përfundimit të këtyre studimeve do të bjerë ndesh me objektivat e këtij programi, të cilat janë absolutisht shumë të mëdha se ai titull që studenti do të mbajë. Duke qenë se studenti merr njohuri për psikologjinë dhe jo vetëm, po aq kredite dhe njohuri merr edhe nga lëndët sociologjike duke e bërë diplomën e njohuritë e tij të ndahen në mes të këtyre shkencave. Ndaj sërish i mbetemi mendimit se ose nevojitet të ndryshojnë objektivat e programit, ose kurrikula e tij duke u fokusuar më tepër në njërën prej këtyre shkencave (nga diskutimi me përgjegjësen e departamentit dhe GVB u qartësua dhe shpjegua një nevojë ose domosdoshmëri e tillë gjatë vizitës në institucion), ose titulli i programit (çka kuptueshmërisht mbetet një sfidë e vështirë për t'u realizuar).

**Ndaj, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**-Për komentin:** *Lenda bazat e Studimeve Psikosociale bazohet ne eksperiencen boterore qe e ka origjinen ne punen e Institutit Tavistock ne Angli. Kjo lene zhvillohet dhe njihet ne disa katedra akademike te botes, ka nje literature te gjere ne dispozicion si edhe ka nje sere seminaresh dhe trajnimesh qe kane per haze modelet thelbesore qe trajtohen ne te. Per here te pare kjo lende jepet ne nje kateder te shqiperise. Mund. ta gjejme me emertesa te ndryslune si Social-Psikologjia, Studimet Psiko-Sociale apo sikurse eshte edhe me e njohur Psikodinamika e Grupeve. Ne thelb eshte aplikimi i parimeve psikodinamike ne trajtimin e grupeve dhe te organizatave. Modeli vjen nga kombinimi i kontributit te orientimit Klenian dhe Bionian (sidomos ne studimin e grupeve, studime te zhvilluara ne Institutin Tavistock) ne Psikodinamike, i Leëin me teorine e tj te fushes dhe studimet e zhvilluara brenda Institutit Tavistock si edhe i teorise se sistemeve.*

*Te gjitha keto jane paraprakisht te nevojshme per nje formim te metejshern ne psikologjine organizative. Per nga gershetimi qe ka ne permbajtje i disa orientime dhe kontribute qe shpesh koniderohen te kunderta, mund te rezultojne e mbivendosur me disa lende te tjera, sikurse mund te permendim psikologjine e personalitetit, per nga rendesia e perbashket qe i japin orientim psikodinamik. Ne te vertete ka ndryshime. Kjo lende trajton vetem nje pjese shume specifike te ketij kontributi, pikerisht ate qe njihet si orientimi Klenian i rnarredhenies objektuale si edhe kenveshtrim Bionian te cilet, po te shqyretohet me kujdes, syllabusi i Teorive te Personalitetit as nuk i citon dhe as nuk i trajton fare. Lenda Nderveprim Social ka nje qasje sociologjike dhe me specifikisht te atij orientimi te sociologjise qe i referohet*



*nderveprimit simbolik dhe konstruksionizmit social. Kjo eshte arsyeja pse autoreve qe i jepet rendesi, jane Mead dhe Goffman. Eshte e rendesishme qe studentet te njihen me nje kontribut te tille pasi perben qasjen me bashkekohore ne kete kendveshtrimin. Do te ishte gabim te mbronim idene qe lenda e Psikologjise Sociale nuk ka ndikime nga sociologjia, perkundrazi, nje pjese e mire e autoreve sociologe kane dhenen kontribut te vyer ne studime dhe teori baze te kesaj fushe. Kjo eshte arsyeja pse permenden ne hyrjen qe i behet kesaj lende. Objektivi dhe qellimet i saj mbeten ne cdo rast te ndryshme dhe te pasqyruara ne syllabus. Lenda e Komunikimit ne Shoqeri, ne permbajtjen e saj i jep rendesi strukturave te komunikimit sikurse jane simbolet, kodet, ideologjite, media dhe ndikimi i gjere i globalizimit. Sigurisht qe, elemente e nderveprimit dhe te ndermjetesimit nuk mund te mbeten pa u trajtuar ne nje tematike kaq te gjere sic eshte komunikimi ne shoqeri.*

*Ne lidhje me lenden Konjicioni Social studentet kane perfituar njohuri te pergjithshme ne fushen e Psikologjise Konjitive dhe kjo eshte reflektuar ne syllabusin e lendes, Tematikat te cilat jane trajtuar gjate oreve te leksioneve perbejne nje perqindje te konsiderueshme te Psikologjise Konjitive dhe nder to permendim, perfaqesimet mendore, ndijimi dhe perceptimi, proceset e vemendjes, kujtesa, gjuha, zgjidhja e problemit, inteligjenca, zhvillimi konjitiv dhe konjicioni social. Gjithashtu, theksi i vihet pajisjes me njohuri te studenteve ne fushen e Neuroshkences Konjitive.*

GVJ sërish reagon ndaj këtij objeksioni të ardhur nga institucioni UMSH duke argumentuar se ai është në vijueshmërinë e rekomandimeve të mësipërme. Edhe gjatë vizitës në institucion në diskutimet me përgjegjësin e departamentit dhe me GVB u rekomandua nevoja për rishikim të kurrikulës për ta përmirësuar atë dhe sjellë më afër synimit që vetë departamenti dëshironte, pikërisht drejtimit Psikologjik. Lëndët e mësipërme si **Bazat e studimeve Psikosociale** apo **Ndërveprimit social** absolutisht që nuk diskutohet të jenë lëndë të rëndësishme në shumë universitete të botës që kanë rëndësi të veçantë për kontekstin e programeve ku ato trajtohen. Por sugjerimi i bërë për të tre lëndët lidhur me nevojën edhe të departamentit dhe të programit për ta afruar me drejtimin psikologjik. Nga ana tjetër, përmbajtja e këtyre lëndëve duke qenë se ishte një përmbajtje e gjendur dhe herë pas here e përsëritur edhe në lëndë të tjera të këtij programi si Psikologji sociale, Komunikimi në shoqëri, apo edhe Kognicioni social nga ku studenti mund të marrë informacion, vlerësohet se zëvendësimi i këtyre lëndëve me lëndë të tjera më të nevojshme për njohuritë e një studenti në Psikologji do të ishte i rëndësishëm. Gjithësesi, këto mbeten rekomandime që do të kenë lirinë të vlerësohen absolutisht prej institucionit. Ndaj vlerësojmë se **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Sipas dokumentit “Misioni dhe objektivat e programit”, programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka si qëllimin e tij kryesor “...përgatitjen e kapaciteteve në fushën e kujdesit psikosocial dhe përshtatjes sa më të mirë të këtij sektori me standardet europiane”. Për realizimin e këtij qëllimi kryesor, misioni kryesor i këtij programi përfshin: 1) përgatitjen e specialistëve në fushën e psikologjisë me fokus të veçantë në aspektet sociale, këshillimore, klinike, familjare dhe organizative; 2) krijimin e një programi konkurrues në fushën e psikologjisë me synimin për të formuar psikologë të ardhshëm me dije bashkëkohore nisur nga tradita dhe eksperiencia ekselente e disa nga univesiteteve më prestigjioze në botë; 3) ngritja e bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve me ente publike dhe private si edhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit (për rritjen e nivelit të shkëmbimeve dhe përvijës profesionale si edhe të kërkimit shkencor); 4) forminin e specialistëve të sektorit të kujdesit psikologjik për institucione shtetërore, organizatat jofitimprurëse si dhe të tjerë sektorë privatë si në shërbime dhe biznese; 5) të formojë specialistë në fushën e këshillimit dhe terapisë psikosociale në sketoret e kujdesit shëndetësor për institucionet shtetërore, në organizatat jofitimprurëse si dhe në sektorët privatë të biznesit dhe shërbimeve; etj.

Për realizimin e këtij misioni të gjerë, programi i studimit ka hartuar disa objektiva lidhur me aftësitë fushat dhe kompetencat formuese të studentit të diplomuar në këtë program, duke synuar gjerësisht pajisjen e studentit me një formim sa më bashkëkohor në psikologji, përvetësimin nga ana e studentëve të terorrive sociale, këshillimore, klinike dhe marrëdhëniet e njeriut në kontekstet organizative, pajisjen me njohuri multidisiplinare, etj.

Sipas vlerësimit të kryer nga UMSH, studentët e diplomuar në këtë program studimi do të jenë psikologë të aftë dhe të kualifikuar për të punuar në sektorin publik dhe privat të shëndetësisë, kujdesit psikosocial, organizatave jofitimprurëse, etj. Gjithashtu, me diplomimin në programin e studimit Bachelor në Studime Psikosociale, studentit i hapet rruga drejt profesioneve të psikologut dhe psikoterapistit si dhe të kërkuesit shkencor në fushën e punësimit privat, në shëndetësi dhe në administratën publike.

Nisur nga sa më sipër dhe nga sa përshkruhet edhe në RVB, si edhe në deklaratat e bëra përgjatë vizitave në institucion, programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” synon të diplomojë psikologë, të cilët, me pajisjen me njohuritë dhe aftësitë e përshtatshme dhe bashkëkohore përmes studimeve në këtë program, do të mund të ofrojnë shërbimin e tyre të specializuar në të gjithë sektorët ku angazohen psikologët.

Vlerësojmë se jemi në kushtet në të cilat ka ndryshuar konteksti i zhvillimeve të profesionit të psikologut nga periudha në të cilën programi është licensuar. Në kriteret e licensimit të psikologut sipas ligjit “Për urdhrin e psikologut në republikën e Shqipërisë”, Nr. 40/2016, sipas të cilit, në Nenin nr. 7 “Kriteret e anëtarësisë” përcaktohet se anëtari i Urdhrit të Psikologut (licensimi si psikolog), ndër të tjera, duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Psikologji. Programi i studimit “Studime Psikosociale” nuk ofrohet në Psikologji, ose Psikologji Sociale (si një fushë e specializuar e psikologjisë dhe e cila ka pikëprereje të shUMSHa me Sociologjinë), duke e vënë në pikëpyetje procesin e licensimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi në Urdhrin e Psikologut.

GVJ vlerëson se ky nuk është një program studimi i cili ofrohet në psikologji sepse, sikurse do të përshkruhet më në detaje në pikën 9 të këtij raporti, në nënpikën “Kriteret e pranimit të studentëve”, në vitin akademik 2018-2019, në këtë program studimi janë pranuar të regjistroheshin studentëve me mesataren e



shkollës së mesme nën notën 7. Sipas Vendimit Nr. 216, datë 20.04.2018 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”, në pikën 3 “Për kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2018–2019, nota mesatare e përllogaritur, sipas këtij vendimi, të jetë nota 7 (shtatë). Programet e studimit të fushës së mësuesisë përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.” Në shtojcën 1 të këtij vendimi të sipërcituar, nuk është i listuar programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, duke mos e njohur si program studimi në fushën e Psikologjisë.

Bazuar në vlerësimin e mësipërm, studentët e diplomuar në programin e studimit bachelor në “Studime Psikosociale” pas diplomimit në këtë program nuk mund të regjistrohen në Urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë, duke i bërë objektivat dhe misionin e këtij programi të papërputhshme me kuadrin ligjor që rregullon profesionin e psikologut në Republikën e Shqipërisë.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke synuar formimin e specialistëve të cilët të mund t’i shërbejnë më së miri interesave të vendit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka objektiva të qarta për formimin e studentëve që ndjekin atë program studimi, si në nivel të njohurive edhe në terma të aftësive profesionale.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është hartuar duke vlerësuar kërkesat e tregut të punës. Mirëpo sipas dokumentit “Analizë e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e programeve Bachelor dhe Master në SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, në faqen 3 të këtij dokumenti, në pikën 5 të tij, referenca ndaj këtij programi është e lidhur me “Psikologjinë sociale”, si një ndër dy degët që ofrohen në treg (sipas dokumentit të sipërcituar). Nuk ka përputhje midis përcaktimeve të bëra në këtë analizë tregu dhe vetë emërtesës së programit, i cili nuk është në “Psikologji sociale” por në “Studime psikosociale”.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka marrë marrë në konsideratë zhvillimin ekonomik të vendit, duke përcaktuar punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi si psikologë në sektorin publik dhe atë privat. Ajo që mbetet për t’u rikonsideruar është pamundësia e studentëve që me diplomën në Bachelor në “Studime Psikosociale” nuk mund të anëtraësohen në Urdhrin e Psikologut, dhe si rrjedhojë nuk mund të ushtrojnë profesionin e psikologut, pavarësisht zhvillimit ekonomik të vendit dhe kërkesave të tregut të punës për psikologë.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë	Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është përshtatur



<p>përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>me strategjinë e institucionit, në mënyrë të veçantë me qasjen pozitive ndaj programeve me kryqëzim të disiplinave. Ashtu sikurse paraqitet në dokumentin “Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 2018-2023” si dhe në deklarat e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike si dhe me Drejtuesen e Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, në planin strategjik, Psikologjia mund të rikonsiderohet si me një shkrirje me programe në fushën e Pedagogjisë. Kjo do të duhet të bëhet pas një vlerësimi të kujdesshëm, në mënyrë që të mos krijohet pengesa në regjistrimin e studentëve në këtë program miks në Urdhër të Psikologhit dhe, për rrjedhojë, edhe ushtrimin e profesionit të psikologut.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është hartuar për ta pajisur studentin me njohuri dhe aftësi të përshtatshme me profilin përkatës.</p> <p>Ashtu sikurse u paraqit edhe më sipër, profili i programit të studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ka si objektiv formimin e shprehive të profesionit të psikologut, në mënyrë më specifike të psikologut social.</p>
---	---

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ul>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” synon të plotësojë kërkesat e tregut të punës për profesionistë në fushën e shëndetit (psikologë dhe psikoterapistë);</p> <p>Studimi i tregut është bërë në shtator 2015 dhe është pasuar me një analizë të vitit 2018. Në të dy këto dokumenta është synuar të vlerësohet mundësia e punësimit të studentëve të diplomuar në tregun vendas dhe atë të huaj, edhe me synimin për të bërë një projeksion të numrit potencial të studentëve në të ardhmen.</p>
---	--

**Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” nuk bie ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” tenton të ruajë vlerat kulturore kombëtare.</p>
--	---

**Konkluzione të GVJ:**

1. *Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është i hartuar me një kornizë të plotë misioni dhe objektivash, por ka nevojë të rishikohet mundësia e realizimit të objektivave lidhur me formimin e psikologëve dhe psikoterapistëve, në të gjithë sektorët e punës në vend, pasi nuk plotëson detyrimet e dala nga korniza ligjore që rregullon profesionin e psikologut, antërrarësimin e Urdhër të Psikologut në republikën e Shqipërisë dhe fitimin e të drejtës për të ushtruar profesionin.*
2. *Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është hartuar në vitin 2016. GVJ vlerëson*






se ky program është në harmoni edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit 2018-2023, por gjykohet se është e nevojshme që, pavarësisht synimit për të krijuar programe ndërdisiplinore, ky program specifik ka nevojë të rishikohet; ose të rishikojë titullin e diplomës duke e profilizuar në psikologji (p.sh Psikologji sociale), ose të rikonsiderojë objektivat e vetë programit, duke mos synuar të diplomojë psikologë, të cilitdo profil të psikologjisë.

3. Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” është hartuar për të plotësuar kërkesat e tregut të punës për psikologë, të profileve të ndryshme të psikologjisë si dhe në sektorë të ndryshëm të punës në vend. Mirëpo, emërtesa dhe vetë struktura lëndore e planit mësimor të këtij programi studimi e pengojnë studentin e diplomuar në këtë program studimi për t’u licensuar dhe, për rrjedhojë për të ushtruar profesionin si psikolog. Kjo për shkak se “Studimet Psikosociale” nuk janë një program Bachelor në fushën e psikologjisë dhe si i tillë bie ndesh me kriteret ligjore që përcaktojnë licensimin si psikolog.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Ashtu sikurse përshkruhet në RVB, mbështetur në dokumentacionin që shoqëron RVB si dhe e deklaruar në takimet gjatë vizitave në institucion, Programi i studimit Bachelor në “Studime Psikosociale” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Ky fakultet është një nga tre fakultetet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe përbëhet nga tre njësi bazë: 1) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë; 2) Departamenti i Shkencave Politike dhe 3) Departamenti i Administrimit Publik dhe formimit Bazë.

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike është hapur me Urdhrin Nr 273, datë 18.05.2017, në të cilin përcaktohej edhe riorganizimi i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i cili përbëhet nga tre njësi bazë: 1) Departamenti i të Drejtës Publike; 2) Departamenti i të Drejtës Civile dhe 3) Departamentii Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është një institucion i arsimit të lartë i cili e mbështet aktivitetin e tij akademik dhe kërkimor në dokumentacion zyrtar, në të cilin përcaktohen qartë: misioni; objektivat; strategjitë e zhvillimit; rregulloret e strukturave akademike dhe atyre ndihmëse si dhe rregulloret e vetë programeve; syllabusët e lëndëve përkatës, etj.

Ashtu sikurse citohet në RVB dhe sikurse është dëshmuar në dokumentacionin bashkëngjitur këtij raporti, qëllimi kryesor i UMSH-së është pajisja e gjeneratave të reja me dije të nivelit të lartë, me aftësi për t’u përshtatur me tregun e punës; me interesa thelbësor për të vazhduar studimin dhe pasurimin e materialit shkencor në vijimësi dhe pa ndërprerje.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Sipas strukturës akademike, Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë është pjesë e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike së bashku me Departamentin e Shkencave Politike dhe Departamentin e Administratës Publike dhe Formimit Bazë. Brenda departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, janë tre struktura të ndara sipas profileve të gruplëndëve përkatëse, të profileve: Psikologji



Klinike; Psikologji Organizative dhe Komunitare dhe Shkenca Sociale. Stafit akademik është grupuar në këto gruplëndë.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës. (Shiko Tabelen 1 dhe 2).

Ashtu sikurse paraqitet në tabela 1 dhe 2, aktualisht, stafi akademik i cili është i përfshirë në mësimdhënie në Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë është:

Për vitin akademik 2018-2019: 11 PAE, nga të cilët: Asoc. Dr.; 4 PhD; 1 Prof. 1 Dr; 5 MsC.

5 PAK, nga të cilët: 1 Prof. Dr; 2 Dr dhe 2 MsC.

Për vitin akademik 2017-2018: 9 PAE, nga të cilët: 1 Prof. Asoc. Dr.; 4 PhD; 1 Dr; 3 MsC.

7 PAK, nga të cilët: 2 Prof. Dr; 3 Dr; 1 PhD dhe 1 MsC.

Për vitin akademik 2016-2017: 5 PAE, nga të cilët: 2 Prof. Asoc. Dr dhe 3 MsC.

2 PAK, nga të cilët 1 Prof. Dr dhe 1 Dr.

Gjatë viteve, ka një përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik efektiv dhe për të ulur numrin e personelit akademik me kontratë. Gjithashtu vihet re një përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik të specializuar në fushën e psikologjisë, edhe pse, ashtu sikurse do të paraqitet në vijim në raport, ky numër ende nuk është arritur. Edhe profili i vetë drejtueses së departamentit nuk është në fushën e Psikologjisë.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

Ashtu sikurse paraqitet në RVB dhe sikurse u deklarua edhe gjatë vizitave në institucion, personeli akademik është i ndarë në Personel Akademik Efektiv, Personel Akademik me Kontratë, Personel Administrativ. Personeli akademik përzgjidhet, në varësi të nevojave të departamentit, nga një komision i përbërë nga: Dekani, Drejtuesi i Departamentit, drejtuesi i grup-lëndëve përkatëse (grupi në të cilat bëjnë pjesë lëndët e programuara për anëtarin përkatës të stafit akademik) si dhe një përfaqësues i Burimeve Njerëzore. Për këtë proces rekrutimi ka të dhëna të cilat ruhen në një regjistër të vecantë. Për anëtarët, të cilët gjatë procesit të rekrutimit rezultojnë me pikë të njëjta, parashikohet kryerja e një raundi të dytë të intervistës.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, për programin e studimit. (Shiko Tabelen nr 4 dhe 5).

Sipas të dhënave të paraqitura në RVB si dhe sipas deklarimeve në disa prej takimeve në institucion, gjatë viteve akademike 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019 ka patur një rritje të numrit në total të personelit akademik (si PAE dhe PAK) si dhe një rritje, në mënyrë të vecantë, të Personelit Akademik Efektiv.

Viti akademik 2016-2017 5 PAE dhe 2 PAK (rreth 80% e ngarkesës së programit për këtë vit akademik mbulohet nga staf PAE dhe rreth 20 % e ngarkesës nga staf PAK)

Viti akademik 2017-2018 10 PAE dhe 2 PAK (rreth 88% e ngarkesës së programit për këtë vit akademik mbulohet nga staf PAE dhe rreth 12 % e ngarkesës nga staf PAK)

Viti akademik 2018-2019 17 PAE dhe 5 PAK (82% e ngarkesës së programit për këtë vit akademik mbulohet nga staf PAE dhe rreth 18 % e ngarkesës nga staf PAK)

Nga vëzhgimi i dokumentacionit të ngarkesës së stafit akademik të brendshëm efektiv në departament si dhe takimet me stafin efektiv dhe atë me kontratë mund të thuhet se stafi akademik me kontratë ka ngarkesë



relativisht në këtë program studimi prej 3-4 lëndë dhe në programe të tjera të UMSH si psh në Msc me profile ne Psikologji komunitare dhe Organizative rreth 2-3 lëndë. Vlerësohet se stafi akademik i brendshëm PAE të japë maksimumin e ngarkesës mësimore në UMSH. Disa prej anëtarëve të stafit PAE janë të angazhuar edhe si pedagogë të jashtëm pranë UT, FSHS.

Përsa i përket ngarkesës mësimore së stafit të brendshëm PAE që lektrojnë në këtë program studimi dhe në programe të tjera studimi brenda UMSH mund të thuhet se ajo varion nga psh drnt. E Tollkuçi me 4 lëndë në këtë program studimi 225 orë mësimore (maksimumi i ngarkesës për stafin mësimor efektiv), ndërkohë që nuk ka ngarkesa në programe të tjera për vitin 2018-2019, apo M. Çollaku që në këtë program ka 90 orë mësimore dhe po 90 orë në programe të tjera të UMSH me total rreth 180 orë. Përgjithësisht ngarkesa mësimore brenda stafit është shpërndarë sipas titujve dhe gradave të lektorëve dhe programit përkatës si dhe mbingarkesa nuk vihen re.

Të dhëna sipas moshës së personelit. (Shiko Tabelen 6)

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, gjatë viteve akademike 2016-2019 dallohet qartë një tendencë për të rritur numrin e PAE dhe PAK të grupmoshave 36-46 dhe 46-55 vjec, si dhe për të ulur numrin e anëtarve të stafit akademik të grupmoshës 66-68 vjec. Gjithashtu ka një tendencë për të rritur anëtarët e stafit akademik të grupmoshës 25-35 vjec.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Ashtu sikurse paraqitet në RVB dhe sikurse u pohua edhe gjatë vizitave në institucion, të gjithë anëtarët e stafit akademik, si ata efektivë ashtu edhe ata me kontratë, kishin një njohje të detajuar të kuadrit ligjor që rregullonte angazhimin e tyre në UMSH, duke përfshirë detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e tërthorta. Nga shqyrtimi i bërë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u verifikua plotësia e dosjeve personale të stafit akademik. Rekrutimi i stafit akademik është një proces i cili zhvillohet në mënyrë vertikale, duke zënë fill nga parashtrimi i nevojave nga ana e departamentit, në muajt qershor-korrik.

Dosja personale e një anëtari të Stafit akademik përmbante:

- Kontrata e punës;
- CV;
- Deklarata e konfliktit;
- Vendimi për pagën sipas gradave;
- Formular vetdeklarimi, gjendja gjyqësore;
- Letër motivimi;
- Kërkesa;
- Diploma.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Anëtarët e stafit ndihmës/administrativ janë të kualifikuar sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	UMSH ndjek të gjitha procedurat ligjore dhe transparente në fuqi në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Gjithashtu, UMSH siguron që të



<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>gjitha këto të jenë në përputhje edhe me statutin dhe rregulloren e institucionit;</p> <p>Për të gjitha vitet akademike, UMSH ka arritur të angazhojë një numër të mjaftueshëm të personelit akademik efektiv, i cili ka mbuluar, së paku, 70% të ngarkesës mësimore të Programit të studimit “Studime psikosociale”, në të treja vitet akademike;</p> <p>UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të stafit, duke përfshirë përcaktimin e kriterëve sipas kuadrit ligjor për institucionet e arsimit të lartë dhe procedurat transparente të shqyrtimit të kandidaturave dhe shpalljes së fituesve. UMSH, përmes një procesi të vlerësimit nga studentët, vetvlerësimit si dhe vlerësimi nga supervizorët, arrin të sigurojë një proces vlerësimi të plotë të stafit akademik. Ky vlerësim i bëhet me dije anëtarit të stafit akademik me qëllim rritjen e cilësisë;</p> <p>UMSH mban një regjistër të vecantë, i cili arkivon të gjithë elementët e proceseve rekrutuese si dhe të dhënat bazë për secilin anëtar të stafit akademik.</p>
---	---

**Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent.,.</p>	<p>UMSH disponon një bazë të plotë të dhënash për personelin akademik duke e reflektuar në zotërimin e dosjeve të plota dhe të përditësuara të personelit akademik të angazhuar;</p> <p>UMSH disponon listat e plota të personelit akademik të angazhuar për çdo semestër të vitit akademik, duke përfshirë edhe personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Pas përcaktimit të nevojës së staf akademik nga ana e departamentit dhe pas përcaktimit të kriterëve të rekrutimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, lajmërimi dhe procedurat e rekrutimit publikohen në faqen zyrtare të UMSH në internet si dhe në rrjetet e ndryshme sociale për të siguruar aksesin e madh të të interesuarve;</p> <p>Përgjithësisht UMSH bën kujdes që të angazhojë si titullarë të lëndëve/moduleve për programin e studimit “Studime Psikosociale” personel akademik, i cili mban së paku gradën shkencore “Doktor”.</p>
---	---

**Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>Ky program studimi nuk përmban orë laboratorike, por personeli ndihmës kërkimor-shkencor i UMSH dëshmon një kujdes të lartë ndaj mirëmbajtjes së mjediseve ku zhvillohen orët e leksioneve dhe seminareve;</p> <p>UMSH dëshmon një përpjekje të vazhdueshme në drejtim të angazhimit të burimeve njerëzore në funksion të plotësimi të objektivave të programit të studimit “Studime Psikosociale”;</p> <p>UMSH ka angazhuar personel të mjaftueshëm për udhëheqjen e studentëve në orët e praktikës profesionale duke plotësuar raportin e së paku 1</p>
---	--



mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	tutor/instruktor për 12 studentë.
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>UMSH mbështet stafin akademik në kualifikimin e mëtejshëm përmes programeve të vecanta të mbështetjes: ose përmes lehtësimit të ngarkesës mësimore ose administrative, ose përmes mbështetjes financiare të pjesëmarrjes në konferenca shkencore ose projekte të shkëmbimit;</p> <p>UMSH disponon një bazë të plotë të të dhënave sa i takon zhvillimit të programit të studimit “Studime Psikosociale”.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. UMSH njeh dhe respekton detyrimet ligjore të rekrutimit të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë si dhe bën kujdes të vazhdueshëm në drejtim të transparencës së plotë përgjatë të gjithë procesit të rekrutimit të stafit.</li> <li>2. UMSH, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore, zotëron dhe plotëson në mënyrë të vazhdueshme një bazë të dhënash për personelin e tij, si në nivel të Departamentit edhe në nivel të plotësimi të detyrimeve ligjore në drejtim të mbulimit të ngarkesës mësimore të programit specifik të studimit.</li> <li>3. UMSH, përmes stafit akademik dhe stafit mbështetës ndihmës-akademik, lehtëson në mënyrë të vazhdueshme procesin mësimor si dhe mbështet studentët në realizimin e praktikave profesionale në institucione partnere.</li> <li>4. UMSH ka një vëmendje të posacme ndaj mbështetjes së stafit akademik në kualifikimet e tij të vazhdueshme, kryesisht përmes mbështetjes së projekte dhe pjesëmarrjes në aktiviteteve me natyrë kërimore-shkencore.</li> </ol>	

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.*

UMSH është i pozicionuar në një vendndodhje relativisht të lehtë për t'u aksesuar nga studentët, në një zonë pak metra nga qendra. Është një universitet i cili e zhvillon aktivitetin e tij në një godinë të re, të pajisur me salla në të cilat zhvillohen orët e leksioneve dhe seminarëve, salla në të cilat zhvillohet aktivitetet mbështetëse të mësimdhënies të tilla si: biblioteka; salla e konferencave; laboratorët e teknologjisë së informacionit dhe gjuhës së huaj, etj.

Procesi i mësimi zhvillohet përgjatë ditëve nga e hëna në të shtunë, në tre fasha oraresh, midis orëve 08:00 – 21:00. UMSH ndodhet në një zonë të Tiranës, tanimë e cilësuar si zonë universitare, iu krijon studentëve mundësinë e rrjetëzimit me studentë të tjerë, gje e cila ka sjellë edhe lehtësimin e realizmit të aktiviteteve të përbashkëta midis tyre.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**



Mjediset për Programin e studimit. (Shiko Tabelen 7)

Mjediset për stafin. (Shiko Tabelen 7)

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Sipas RVB dhe pas verifikimit të bërë në vizitat në UMSH, GVJ konstatoi se Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë orienton studentët dhe vë në dispozicionin e tyre një numër të konsiderueshëm tekesh mësimore bazë dhe të natyrës së literaturës ndihmëse;</p> <p>Biblioteka, e cila gjendet në katin e nëndhëshëm të UMSH, disponon një numër të konsiderueshëm titujsh, të cilët shërbejnë si literaturë e nevojshme për të ndihmuar studentin në realizimin me sukses të programit “Studime Psikosociale”;</p> <p>Biblioteka zotëron 4162 tituj revistash, librash dhe materialesh të tjera shkencore në fusha të ndryshme. Programi “Studime psikosociale” mbështetet nga 133 tituj librash, që shërbejnë si literaturë e detyrueshme dhe literaturë mbështetëse. Gjithashtu biblioteka online zotëron 327.325 tituj librash. Përpos kësaj, studentëve iu sigurohet akses në bibliotekën online questia.com dhe “The economist”.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit, në mënyrë periodike, kërkon nga stafi akademik (kryesisht sipas grup-lëndëve) që të propozojnë shtimin e titujve të ndryshëm akademike dhe jo vetëm.</p> <p>Biblioteka është e hapur në të gjithë orarin e studimit, ndërsa biblioteka online siguron akses në mënyrë të pandërprerë.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë,</p>	<p>UMSH zotëron një bazë logjistike e cila i shërben më së miri në realizimin programeve të studimit, duke përfshirë: 71 PC për studentët; 10 laptop për stafin akademik dhe stafin e administratës; 62 PC për stafin akademik; 6 PC për administratën; 3 printera dhe dy fotokopje.</p> <p>Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet e përshtatshme mësimore për të lehtësuar procesin mësimor të programit përkatës;</p> <p>UMSH zotëron 2 laboratorë për realizimin e orëve të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Programi i studimit “Studime psikosociale” nuk parashikon punë laboratorike dhe, për rrjedhojë, nuk kërkon që institucioni të disponojë një laborator të posacëm për të.</p>



linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj. <b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.	Të gjitha sallat ku zhvillohet mësimi në UMSH janë të pajisuar me mjete audiovizuale, të cilat lehtësojnë procesin mësimor. Aksesit i pandërprerë në internet si dhe pajisjet e tjera kompiuterike mbështesin realizimin e procesit mësimor.
--	--

**Konkluzione të GVJ:**

1. UMSH disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 90 m<sup>2</sup>, e cila zotëron tituj të larmishëm akademikë, shkencorë, të cilët shërbejnë si literaturë bazë apo si literaturë mbështetëse për studentët e programit të studimit “Studime Psikosociale”.
2. UMSH disponon mjedise të bollshme si dhe të pajisuar me mjetet e duhura, të cilat lehtësojnë dhe mbështesin realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, realizimi i praktikave profesionale realizohet përmes mbështetjes në bashkëpunimin me institucione partnere, përmes marrëveshjeve specifike.

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është projekt i OJF “Qendra Mesdheu”, e cila është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë si person fizik me Vendimin Nr. 411, datë 06/07/2007. Objekti kryesor i kësaj OFJ-je është ushtrimi i aktivitetit në fushën e arsimit të lartë. Kjo qendër është e regjistruar në Regjistrin e OJF-ve, sipas përcaktimve ligjore në fuqi. Duke qenë aktivitet i një OFJ-je, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” operon përmes burimeve financiare të auditueshme. Procesi i auditimit zhvillohet cdo vit dhe pasqyrohet në tabelat financiare të poshtë listuara.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (Shiko Tabelen 8)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (Shiko Tabelen 8). Ashtu sikurse paraqitet në RVB dhe ashtu sikurse u deklarua në vizitat në UMSH, burimi kryesor i financimit të universitetit janë të ardhurat nga studentët si dhe nga projektet në drejtim të kërkimit shkencor.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; <b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	UMSH i nënshtrohet procesit të auditit të jashtëm për cdo vit, sipas përcaktimeve ligjore për Organizatat Jofitimprurëse. Ky auditim i jashtëm shoqërohet edhe nga një auditim i brendshëm.
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Raporti i auditimit paraqet në mënyrë të detajuar të gjithë lëvizjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në UMSH. Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMSH, e cila është një



	<p>strukturë organizative e këtij institucioni, operon sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren e UMSH. Kjo njësi emërohet nga Bordi i Administritimit dhe raporton para tij.</p> <p>Raportimet, të cilat mbështeten mbi raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm përfshijnë detaje të lidhura me të gjitha grantet e fituara (vendase ose të huaja) si dhe të gjitha shpenzimeve të kryera për llogari të realizimit të programeve specifike të studimit.</p>
<p><b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b></p> <p><b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UMSH, përmes Njesisë së Auditimit, harton një pasqyrë të hollësishme financiare, duke e vlerësuar tarifën e shkollimit si burimin bazë të të ardhurave. Kjo pasqyrë e detajuar financiare përmban edhe ndarjen e detajuar të burimeve të tjera financiare, duke operuar sipas kuadrit ligjor të OJF-ve.</p> <p>UMSH ka të dokumentuar raportet financiare të tre viteve të fundit.</p> <p>UMSH, përmes tabelave financiare dhe raporteve financiare të vazhdueshme, dëshmon qëndrueshmëri financiare në drejtim të potencialit për të mbështetur financimin më tej të programit të studimit “Studime Psikosociale”.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. UMSH, përmes Njesisë së Auditimit, e cila është një strukturë e përcaktuar në statutin e këtij institucioni, i nënshtrohet një procesi auditimi financiar të përvitshëm. Ky proces auditimi përmbledh të dhëna të detajuara për të gjitha burimet e financimit si dhe planin dhe realizimin e shpenzimeve të kryera. Kjo njësi raporton përpara Bordit të Administrimit dhe plotëson procedurat e deklaratimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</li> <li>2. UMSH, përmes raporteve financiare të hartuara në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, dëshmon për qëndrueshmëri financiare, duke garantuar mbështetjen financiare për realizimin e mëtejshëm të programit të studimit “Studime Psikosociale”.</li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

Nga vizita në institucion dhe përkatësisht nga takimet me Dekanin dhe përgjegjësen e Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, si dhe me drejtuesen e zyrës së njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulës në UMSH, si dhe nga raporti i vlerësimit të brendshëm, si dhe dokumentacioni i kërkuar në institucion, u vlerësua se UMSH si institucion i kushton vëmendje edhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, me qëllim që të sigurojë një veprimtari mësimdhënëse cilësore, të denjë dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, si dhe bazuar në Statut dhe akte të tjera të brendshme rregullatore. Njësia e



sigurimit të brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, prej vitit 2011. Është një zyrë që përbëhet nga 8 anëtarë dhe prej çdo departamenti përkatës, nga sekretaria mësimore dhe nga studentët si përfaqësues të tyre. Staf i ri është përzgjedhur në vitin 2018. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me zyrën e Burimeve njerëzore. Çdo fundvit në zyrën e Burimeve Njerëzore stafi akademik efektiv plotëson formularin e vetëvlerësimit me zëra të ndryshëm për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe këto pasqyrohen në analizën e punës së kësaj zyre për vit akademik. Vlerësimi i pedagogëve bëhet nga format e vetëvlerësimit, vlerësimit të studentëve dhe të komisionit të ngritur nga zyra e NJSBCZH. Kryetarja e kësaj zyre siguroi se standardet për cilësinë e institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Manuali i Sigurimit të Brendshëm është i miratuar nga Senati Akademik. Manuali përmban dhe përshkruan të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e vetëvlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë në kuadër të Fakulteteve të UMSH. Kjo zyrë është gjithnjë në korrent dhe në lidhje me udhëzimet e reja që dalin vazhdimisht nga MAS për rirregullimin e sylabuse të lëndëve. Është një zyrë vazhdimisht në përpjekje për të rritur kontrollin e cilësisë dhe promovuar punën e saj në raport edhe me atë të institucionit. Mban lidhje të ngushta me zyrën e Burimeve njerëzore dhe me atë të Qendrës kërkimore shkencore.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Bazuar në takimin me drejtuesen dhe anëtarët e NJSBC, raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit si dhe studentët e programit mësohet se anketimet kryhen 2 herë në vit për të gjitha lëndët që zhvillohen gjatë vitit akademik, përkatësisht në fundin e semestrave mësimore, përpara fillimit të sezonit të provimeve. Përkatësisht studentët e vitit të tretë të programit kanë zhvilluar aktualisht 5 plotësime anketash vlerësuese për pedagogët.

- Sa studentë janë anketuar

Anketimi kryhet para sezoneve të rregullta të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët prezent dhe që dëshirojnë të plotësojnë anketën. Ky numër përgjithësisht nuk është më i vogël se 60% e studentëve aktivë për vitin akademik.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Mësohet dhe vërtetohet se përpunimi i anketimeve realizohet nga NJSBCZHK, e cila përpunon rreth 25% të anketave të plotësuara të zgjedhura në mënyrë rastësore. Për lëndët, të cilat ndiqen nga rreth 30 studentë, përpunohen të gjitha anketat e plotësuara. Për rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për t'u përpunuar.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Pyetësorët janë përpunuar me metoda sasiore dhe cilësore dhe përfundimet i janë përcjellë edhe drejtuesit të Departamentit të Shkencave Sociale dhe Dekanit. Shpesh rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBCZHK. Përgjithsisht rekomandimet kanë qenë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës, dhe në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Të pyetur edhe studentët vërtetojnë se masa janë marrë dhe përmirësimi është ndier edhe prej tyre.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Gjatë takimit me drejtuesen e anëtarë të kësaj zyre morëm informacionin se NJSBCZHK aktivitetin e saj e zhvillon sipas një plani kalendar të përvitshëm, ku ajo programon kontrollin e vazhdueshme, sektorët dhe proceset, nëpër të cilat do të ndodhë kontrolli. Kjo zyrë informon edhe rektoratin, drejtuesit e



departamenteve në fakultete dhe përmes tyre në mënyrë konfidenciale gjithë stafin e UMSH mbi rezultatet e kontrolleve të bëra, rezultati i paraqitet personit akademik ose administrativ me një zarf të mbyllur. Kjo zyrë synon përmes këtij procesi marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. U bëme me dije edhe përmes zyrës së sigurnimit të cilësisë si edhe përmes takimeve me drejtuesit e universitetit e drejtuesen e departamentit të se një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UMSH. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e punës së kësaj zyre është ridimensionimi i vazhdueshëm i saj përmes ideve të reja për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Raportet e kësaj zyre shkojnë deri në 2-3 herë në muaj. Informacionet që zyra mbledh janë edhe përmes fokusgrupeve dhe feedback-ut të marrë me shkrim dhe me gojë si dhe informacionit dhe të dhënave të marra nga këshilli studentor mbi mendimet dhe këndvështrimin e tyre mbi procesin mësimor apo edhe lëndë të ndryshme kurrikulare.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Shiko Tabelen 9)

Përgjegjësitë i referohen kryesisht strukturës hierarkike organizative të institucionit dhe ato planifikojnë, organizojnë dhe grantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurnimit të cilësisë.

Kjo njësi vlerëson vazhdimisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore si dhe të kurrikulave të Universitetit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga takimet dhe njëkohësisht nga raporti i vlerësimit të brendshëm, si dhe nga format e vlerësimit TIP të vëna në dispozicion, u vlerësua se një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UMSH është pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe lektorët. Ndër problemet më kryesore të referuara kanë qenë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimin, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Gjithashtu nga RVB dhe nga biseda me drejtuesen e zyrës ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, marrja e mendimit të këshillit studentor si edhe pyetësoret me frekuencë semestrale apo mbi një problem specifik, ku merret mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo lektor. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Mësohet nga vizita se NJSBCZHK përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit dhe e paraqet atë në Rektoratin e Institucionit. Raportet përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në raport NJSBCZHK -ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban sugjerime përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Raporti shpallet publikisht. Propozimet e NJSBCZHK shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji</b>	



## **vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.**

**Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;

**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;
- Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me nota/pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Etj.

Nga vizita dhe takimet me antarët e zyrës së sigurimit të cilësisë vërtetojmë se UMSH përdor metodologji vlerësimi për aktivitetet me karakter kontrolli që organizohen nga NJSBCZHK, për secilin nga proceset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, rekomandohen detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese.

Nga ana tjetër, institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre. Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UMSH, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

**Të tërthorta:** si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; pyetje konceptuale; apo intervista.

**Të drejtpërdrejta:** si: dëgjime në auditor.

## **VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË**

### **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma

Sigurimi i cilësisë së brendshme realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e studentëve dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është akredituar institucionalisht në vitin 2017.

UMSH përdor instrumente të përshtatshme për të vjelë informacionin e nevojshëm për të siguruar cilësinë e jetës akademike.

Nga ana tjetër, UMSH ka një politikë dhe rregullore edhe për procedurën e vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe lektorit të lëndës përkatëse për t'u vlerësuar nga disa burime si nga format i vetëvlerësimit, nga student dhe nga autoritetet përkatëse departamentale.



formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Përfshirja e mekanizmave të tillë si grupet e punës, format e kontrollit, organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe të diplomuarit e rrit mundësinë e vjeljes së informacionit nga shumë burime në vazhdimësi.

Zyra e NJSBCZHK vazhdimisht ndikon në ndërgjegjësimin e personelit dhe stafit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe studentët për standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Por këto bëhen të ditura edhe në çdo fillim viti akademik nga zyra e NJSBCZHK. Për këtë personeli akademik firmos një kontratë në të cilën theksohet gadishmëria dhe përfshirja e lektorit në këtë proces vlerësimi.

Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të NJSBCZHK dhe reflektohet në formatet standard të UMSH-së.

### **Konkluzione të GVJ:**

1. Kjo rubrikë e standardit është e një rëndësie të veçantë për UMSH-në, pasi në të i kushtohet një kujdes i veçantë secilit punonjës, akademik apo staf mbështetës, dhe ky i fundit ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBCZHK. Pika të forta të këtij standardi vlerësohen të jenë: funksionimi efektiv i NJSBCZHK, drejtuesja me eksperiencë që kryeson zyrën, ndjekja me rigorozitet e të gjithë procedurës së vlerësimit të cilësisë së brendshme duke përfshirë çdo aktor të mundshëm si studentët aktualë, ato të diplomuar, stafin akademik, vetëvlerësimin, përgjegjësit e departamenteve dhe dekanin, raporti me analizën orientuese për rritjen e cilësisë së mësimdhënies për rritjen e cilësisë në të ardhmen, si dhe dokumentit të marrëveshjes për procesin e vlerësimit të vazhdueshëm në mësimdhënies dhe kërkim shkencor të firmosur mes institucionit/zyrës së NJSBCZHK dhe personelit akademik efektiv apo me kohë të pjesshme.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit bachelor në Studime Psikosociale ofrohet në përputhje me sistemin e Bolonjës për ciklin e parë të studimeve. Programi është i ndërtuar mbi bazën e lëndëve të vlerësuara edhe me kredite ECTS dhe të gjitha këto paraqiten në silabuset përkëtesë të lëndëve. Silabuset përmbajnë edhe informacion të bollshëm mbi mënyrën e organizimit të tyre dhe literaturën përkatëse. Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi sjellin eksperiencat e tyre nga fushat përkatëse social-psikologjike. Edhe punës së pavarur i është dhënë një rëndësi e veçantë përmes orëve praktike dhe detyrave të kursit. Pedagogët që lektrojnë janë me grada shkencore sipas kërkesave në fuqi. Personeli është përzgjedhur sipas kriterëve të përvojës në mësimdhënie dhe eksperiencës. Është një program që ndërthur njohuri bazike në fushat e psikologjisë dhe sociologjisë. Pikëprerjet e këtyre fushave janë të tilla që herë herë edhe mbivendosen duke dhënë sa specifikime aq edhe përgjithësime në to. Edhe pse objektivat e këtij programi studimor i referohen vetëm fushës së psikologjisë, programi përmban edhe po aq lëndë të natyrës sociologjike. Studenti në përfundimin e këtij cikli studimor mban këtë emërtim diplome: “Bachelor në Studime Psikosociale”.



### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion mësohet se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Studime Psikosociale është licënsuar në dt 27 korrik 2016 dhe ka filluar mësimdhënien në vitin akademik 2016-2017. Objektivat e tij janë në mbështetje të formimit sa më bashkëkohor të studentëve në fushën e psikologjisë, të fushave sociale, klinike, këshillimi dhe gërshetimi i këtyre njohurive me njohuri mbi shoqërinë dhe ndikimin e madh që ka kjo e fundit mbi individin, mirëqenien e tij dhe aftësitë e tij vendimmarrëse në organizatë. *Objektivat e këtij programi studimi janë tërësisht në mbështetje të përgatitjes së psikologut (jo detyrimisht psikologut social që nuk është specifikuar në këtë kontekst), por kjo bie ndesh me titullin e këtij programi studimor Studime Psikosociale. Kjo gjë nuk përputhet me titullin e diplomës që studenti do të mbajë.*

Programi dhe kurrikula e studimeve të këtij programi studimesh Studime Psikosociale ka pika të forta për të theksuar vazhdimësinë e marrjes së njohurive në fushën sociologjike dhe psikologjike, por nevojitet të bëhen edhe disa rekomandime të vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës për të përmbushur misionin dhe objektivat e këtij programi studimesh. Të tilla janë:

*Lënda e disiplinës së formimit karakterizues **Bazat e studimeve Psikosociale** e lektuar në vitin e dytë të studimeve ka një karakter që mbulohet edhe nga lëndë të tjera në këtë program, ndaj do të sugjerohej të zëvendësohej me një tjetër lëndë më të nevojshme për studentin për të përmbushur objektivat e këtij programi. Lënda **Anglisht 1 dhe Anglisht 2** paraqitet e njëjta në sylabuse ndaj duhet të ndryshojë përmbajtja e silabuseve në semestrat përkatës. Lënda **Ndërveprim social** po lëndë e disiplinës së formimit karakterizues e lektuar në vitin e dytë të studimeve ka një përmbajtje që përfshin e mbivendoset me lëndët e **Psikologjisë sociale dhe Komunikimit në shoqëri**, ndaj sërish rekomandohet të zëvendësohej me një tjetër lëndë më të nevojshme për studentin për të përmbushur objektivat e këtij programi. Lënda me zgjedhje në vitin e dytë **Histori e mendimit ekonomik** sërish sugjerohet të zëvendësohet me një tjetër lëndë në përputhje me objektivat e programit pasi njohuritë mbi historinë e ekonomisë do të ishin 'luks' për hapësirën e kurrikulës.*

*Lënda **Kognicioni social** si lëndë e disiplinës së formimit karakterizues në vitin e dytë të programit të studimit sugjerohet të ndryshohet në lëndën 'Psikologji kognitive' pasi me emërtimin ekzistues ajo e kufizon shumë konceptin e 'kognicionit' në psikologji. Mbetet sërish sfidë e konsiderueshme emërtimi i programit **Studime psikosociale**, pasi misioni dhe objektivat e programit nuk përputhen qartazi me titullin dhe me përmbajtjen sociologjike të programit. Nga ana tjetër, sërish del nevojë qartësimi i titullit të fituar me këtë diplomë të nivelit të parë dhe mundësisë që studentët e diplomuar nga ky program me një diplomë të nivelit të dytë në Psikologji të marrin licencën për ushtrimin e profesionit në RSH.*

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore të studentit
- 1 orë mësimore = 60 minuta

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë  
Për planet mësimore refehu tabelës 10 tek Anekset, si dhe tabelës 11 po tek Anekset (ndarja e lëndëve sipas veprimtarisë formuese).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit



- Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara  
Për ndryshimet në planin mësimor nga ai i licensuar referohu tabelës 12 tek Anekset.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës  
Për këto të dhëna referohu te tabela 13 tek Anekset.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga vlerësimi i syllabuseve mund të thuhet se secili syllabus përmbante këto të dhëna:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse



Analiza e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve paraqiten relativisht të plota dhe të ndërtuara sipas VKM-së nr 41 të datës 24. 01. 2018. Kanë një strukturë të ngjashme të gjitha. Në hyrje të çdo syllabusi jepet struktura e lëndës, përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, emri i pedagogut që zhvillon lëndën, parakushtet që duhet të plotësohen për të zhvilluar lëndën, çështjet etike në ndjekjen e lëndës, si dhe ndarja e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Janë të përcaktuara detyrimet e studentit dhe forma e vlerësimit. Gjithashtu në syllabus përfshihen edhe detyrimet e studentit për lëndën, rezultatet e të nxënit, temat e leksioneve dhe orëve praktike nëse do të ketë, literatura bazë dhe ajo ndihmëse si dhe kontakti i pedagogut. Zërat e syllabuseve janë të plota dhe ato të nevojshmet. Ndarja e orëve në auditor bëhet sipas veprimtarive të ndryshme (leksion, seminar apo praktikë e provime) për secilën lëndë. (Syllabuset e lëndëve).

Vlen të theksohet gjithashtu se përgjithësisht i gjithë stafi që lekon në këtë program studimi është i specializuar në fushën përkatëse, por stafi akademik i departamentit për lëndët e veprimtarive në disiplina të formimit karakterizues është vetëm 3 lektorë me gradën shkencor Dr ose PhD me kohë të plotë. (CV e personelit akademik që lekon në këtë program studimi)

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Nga të gjitha dokumentet e konsultuara të vëna në dispozicion, por edhe nga bisedat me stafin e programit BSc në Studime Psikosociale në UMSH vërtetohet se ky program jep 180 kredite ECTS duke përfshirë lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje.



<p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kreditet është i konvertuar me rreth 21 orë në auditor, 20-30 orë punë e udhëhequr ose e pavarur e studentit. Ndarja e orëve të punës së studentit është brenda normave të ligjeve në fuqi si dhe është parashikuar në Rregulloren e Fakultetit për programet e studimit.</p> <p>Në një vit akademik studenti grumbullon maksimalisht 60 kredite ECTS. Dhe në tre vite sasia e krediteve të grumbulluara shkon 180 ECTS.</p>
---	---

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.**

<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Pas bisedave me stafin akademik që lektron në program si dhe me përgjegjësin e departamentit vërtetohet se në çdo fillim viti akademik, departamenti projekton lëndët për semestër dhe silabuset e lëndëve vlerësohen. Planet e lëndëve mësimore miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekanë. Departamenti mban të dhënat e caktuara për programin e studimit.</p> <p>Lëndët e detyruara dhe ato me zgjedhje i qartësohen studentëve për vitin akademik.</p> <p>Sekretaria mësimore evidenton ngarkesën mësimore të pedagogut si dhe orët faktike të realizuara në auditor.</p> <p>Në fillimin e çdo semestri pedagogu bën prezantimin e lëndës që do të lektrojnë dhe paraqet te studentët silabusin e saj, literaturën dhe detyrimet e studentit për lëndën.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p>	
<p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për silabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	

**Konkluzionet e GVJ:**

- Programi i studimit plotëson kriteret ligjore në lidhje me politikat e formimit të studentëve. Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit kanë mision dhe objektiva të paraqitura në rregulloren e programit. Por për arritjen e tyre programi në përmbajtje ka nevojë të konsiderojë disa rekomandime si më poshtë:
 

*Lënda disiplinës së formimit karakterizues **Bazat e studimeve Psikosociale** e lektuar në vitin e dytë të studimeve ka një karakter që mbulohet edhe nga lëndë të tjera në këtë program, ndaj do të sugjerohej të zëvendësohej me një tjetër lëndë më të nevojshme për studentin për të përmbushur objektivat e këtij programi.*


*Lënda **Anglisht 1** dhe **Anglisht 2** paraqitet e njëjta në sylabuse ndaj duhet të ndryshojë përmbajtja e sylabuseve në semestrat përkatës.*

*Lënda **Ndërveprim social** po lëndë e disiplinës së formimit karakterizues e lektuar në vitin e dytë të studimeve ka një përmbajtje që përfshin e mbivendoset me lëndët e Psikologjisë sociale dhe Komunikimit në shoqëri, ndaj sërish rekomandohet të zëvendësohej me një tjetër lëndë më të nevojshme për studentin për të përmbushur objektivat e këtij programi.*

*Lënda me zgjedhje në vitin e dytë **Histori e mendimit ekonomik** sërish sugjerohet të zëvendësohet me një tjetër lëndë në përputhje me objektivat e programit pasi njohuritë mbi historinë e ekonomisë do të ishin 'luks' për hapësirën e kurrikulës.*

*Lënda **Kognicioni social** si lëndë e disiplinës së formimit karakterizues në vitin e dytë të programit të studimit sugjerohet të ndryshohet në lëndën 'Psikologji kognitive' pasi me emërtimin ekzistues ajo e kufizon shumë konceptin e 'kognicionit' në psikologji.*

*Mbetet sërish sfidë e konsiderueshme emërtimi i programit **Studime Psikosociale**, pasi misioni dhe objektivat e programit nuk përputhen qartazi me titullin dhe me përmbajtjen sociologjike të tij.*



*Nga ana tjetër, sërish del nevojë qartësimi i titullit të fituar me këtë diplomë të nivelit të parë dhe mundësisë që studentët e diplomuar nga ky program me një diplomë të nivelit të dytë në Psikologji të marrin licencën për ushtrimin e profesionit në RSH.*

*Sugjerohet që të shtohen lëndë të drejtimit psikologjik me qëllim që të përmbushen misioni dhe objektivat e përcaktuara të programit. Lëndë të tilla si Psikologji anormale, Histori e Psikologjisë, Psikologji shëndeti, Vlerësimi e testimi psikologjik, etj. Sugjerohet të shtohen. Kjo mund të realizohet përmes përqindjeve të lejuara prej 20% të ECTS brenda çdo viti akademik.*

*Por emërtimi i këtij programi studimi do të mbetet problematik për aq kohë sa Urdhëri i Psikologut nuk do ta njohë si nivel Bachelor në Psikologji. Ndaj mbetet sfida e institucionit për të negociuar dhe qartësuar këtë ngërç për studentët që ata duke ndjekur këtë program të mundësojnë marrjen e licencimit të tyre pas ndjekjes së studimeve të ciklit të dytë në Psikologji.*

2. Sasia e krediteve për vitin akademik është 60 kredite ECTS dhe në total pas tre vitesh studimi studenti fiton 180 ECTS. Informacioni i nevojshëm i vihet në dispozicion studentëve nga njësitë kryesore në fakultet, zyra e regjistrimit të tyre. Ndërkohë pranë studentëve qëndron gjithnjë një pedagog si tutor e këshillues i tyre për udhëzimet në ndjekjen e lëndëve të programit dhe atyre me zgjedhje për t'i ndihmuar ata të përputhin kurrikulën me interesat e tyre. Studentët njihen me sylabuset e lëndëve edhe nga pedagogët përkatës si dhe politikat e frekuentimit të lëndës.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

Nga takimet me përgjegjësen e departamentit dhe me pedagogët lektues në këtë program studimi, mësimdhënia realizohet sipas lëndëve të veçanta që përmban programi i studimit, kryesisht në formën e leksioneve dhe seminareve. Format e përdorura janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, detyra të ndryshme, praktikat profesionale dhe orët e konsultimit. Leksionet synohen të jenë interaktive dhe të japin formim të plotë teorik të lëndës për studentin, njohuri të cilat më pas kontrollohen nëpërmjet seminareve. Ngarkesa mësimore për pedagogë është përgjithësisht në përputhje me normat e lejuara. Kontrolli mësimor bazohet në seminarët, që zënë 10 % të vlerësimit të përgjithshëm, provimet e ndërmjetme ose detyrat e kursit, që zënë 20 – 30 % të vlerësimit të përgjithshëm dhe provimit përfundimtar, i cili zë pjesën më të madhe të vlerësimit, 60 -70 % të tij. Vlerësimi i brendshëm kryhet nëpërmjet përgjegjësit të Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike dhe nga organet e tjera administrative të institucionit. Aktivizimi i studentëve kryhet përgjithësisht nëpërmjet pjesëmarrjes si dëgjues në aktivitete shkencore ose në përfshirjen e herë pas herëshme në punën kërkimore të pedagogëve.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione **930** orë në auditor
- Seminare **825** orë në auditor
- Praktikë profesionale **120** orë në auditor
- Diploma **20** orë në auditor

- Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive janë:



- Pjesëmarrja dhe aktivizimi gjatë frekuentimit të lëndës - 10 %
- Detyra e kursit apo edhe testime në mesin e semestrit – 20 %
- Provimi përfundimtar –70 %

Studentët referojnë gjithashtu të jenë pjesëmarrës në leksione dhe detyra kursi apo edhe diskutime e debate të ndryshme gjatë orëve të leksionit dhe seminareve.

Kryesisht ka përputhje midis specializimit të pedagogëve dhe lëndëve që ato lektrojnë.

Metodat e mësimdhënies variojnë nga forma klasike e mësimdhënies por edhe përmes debateve dhe diskutimeve, teknika e brainstorm-it, studimet e rastit, role-play, etj. Janë organizuar edhe leksione të hapura. Ndërkohë vlerësimi i brendshëm i pedagogut realizohet nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit. Studentët japin mendimet e tyre për këtë proces dhe kjo vlerësohet si reale dhe ndihmuese për procesin dhe përfshirjen e studentëve.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Prej departamentit ka pasur përpjekje për të përfshirë studentët në jetën kërkimore të departamentit. Ka grupe pedagogësh që punojnë duke përfshirë studentët më të mirë në punët shkencore të departamentit. Mund të përmendet aktiviteti i muajit nëntor 2018 ku një pjesë e studentëve kanë qenë pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga EMDR Albania mbi ‘zhvillimet e reja në fushën e çrregullimeve psikologjike dhe mendore’. Studentët mësohet të kenë qenë edhe të angazhuar në ëorkshope të ndryshme e trajnime. Gjatë muajit Janar 2019 studentët janë përfshirë në trajnimin për SPSS të organizuar nga qendra FORPSICOM, Universiteti Aldo Moro, Bari. Edhe organizimi i orëve praktike është një komponent i rëndësishëm për të rritur aftësitë e studentëve. Studentët kanë pasur mundësi të shohin aktivitete të ndryshme në fushën e psikologjisë si linja për mbështetje të grave viktime të dhunës në familje për të njohur praktikën psikosociale. Megjithatë, sugjerohet të nxitet edhe më tepër pjesëmarrja e studentëve në veprimtaritë kërkimore të departamentit.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

Nga raporti i vlerësimit të brendshëm, takimet me sekretarinë mësimore dhe përgjegjësën e departamentit mësohet se pranimi i studentëve mbështet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregullatore të institucionit. Institucioni llogarit kapacitetin fizik dhe atë të stafik akademik për të përmbushur nevojat e programit. Më pas kuotat publikohen dhe përlllogariten edhe regjistrimet. Kohëzgjatja mesatare e zgjatjes së studimeve është 6 semestra. Në tre vitet e regjistrimit për këtë program studimi që prej 2016-tës vihet re një rritje e numrit të studentëve. Një përqindje e tyre janë të regjistruar prej maturave shtetërore dhe një pjesë tjetër vijnë në program me transferime.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Nëse do t'i referoheshim procedurave të pranimit të studentëve në UMSH ka një zyrë që është Zyra e informacionit dhe mbështetjes së studentëve, e cila kujdeset për sqarimin e procedurave të nevojshme për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj si dhe sekretaria mësimore. Politikat e pranimit të studentëve janë të qartësuara në rregulloren e insitucionit dhe të programit të studimit.

Në këtë institucion ka disa dokumente që aplikanti dhe studenti duhet të dorëzojnë si më poshtë:



- Formulari i aplikimit
- Fotokopja e noterizuar e diplomës së maturës shtetërore bashkë me certifikatën e notave;
- 2 fotografi;
- Deklaratën e udhëzimit përkatës të vitit akademik aktual;
- Nota mesatare të jetë minimalisht 6.5.

Gjithësesi nota mesatare përcaktohet edhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave sipas vitit akademik përkatës. Nota mesatare është e paqartë për shkak të titulli të programit të studimit Studime Psikosociale, ka nuk është e specifikuar qartësisht për studentët që do të ndjekin studime për Sociologji apo Psikologji duke qenë se VKM-ja e ka të ndryshme notën mesatare për secilën nga degët.

Studentët këshillohen para dhe gjatë studimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Numri total i studentëve të regjistruar nga viti 2016 dhe deri në vitin 2018 si të regjistruar për herë të parë është rreth 83 studentë për programin e studimit dhe të transferuar janë 41 studentë. Studentë të diplomuar deri tani nuk ka. Përgjithësisht studentët në hyrje kanë pasur një mesatare prej 7.19, ndërkohë që mesatarja e studentëve të transferuar është 7.3.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Numri total i studentëve të regjistruar nga viti 2016 dhe deri në vitin 2018 si të regjistruar për herë të parë është rreth 83 studentë për programin e studimit dhe të transferuar janë 41 studentë. Përgjithësisht studentët në hyrje kanë pasur një mesatare prej 7.19, ndërkohë që mesatarja e studentëve të transferuar është 7.3.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka ende studentë të diplomuar.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

UMSH aplikon edhe transferime të studentëve nga universitete të tjera. Studentët lejohen të transferohen me sistemin e krediteve ECTS në fillim të vitit akademik në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe duke respektuar rregulloren e institucionit për këtë procedure. Ngrihet një komision që shqyrton kërkesën e aplikantit dhe më pas 10 ditësh del vendimi për miratimin ose jo të kërkesës së studentit si dhe çfarë procedure do të ndjekë për vazhdimin e studimeve. Edhe pse ka pasur numër në rritje të studentëve të regjistruar dhe të transferuar në këtë program studimi, mbetet e rëndësishme të theksohet se programe të tilla studimore të ndërthurura mes studimeve psikologjike e atyre sociologjike nuk janë të aplikuara në universitete të tjera publike (përveç Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës) apo jo publike. Nga ana tjetër, një kurrikul e tillë vështirëson apo bën të pamundur aktualisht marrjen e licënsimit të studentëve që do të kenë një nivel studimi akademik në Psikologji kur ata të duan të dalin në tregun e punës dhe të kenë përfunduar edhe një nivel të dytë studimor akademik masteri të specializuar. Studentët ishin në dijeni të këtij ngërçi dhe shprehën shqetësimin e tyre me shpresën e bashkëpunimit të institucionit të UMSH me Urdhërin e Psikologut në RSH për qartësimin e tij.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	Vërtetojmë se nga bisedat me përgjegjësin e departamentit dhe dekanin si dhe shqyrtimin e dokumentacionit të rregullores së institucionit për kriteret e pranimit, procedurat e pranimit të studentëve në ciklin e parë



<p>dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>BSc Studime Psikosociale në institucionin e UMSH janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Studenti duhet të ndjekë dorëzimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për të qenë i pranuar pranë UMSH.</p> <p>Për programin e këtij Bachelori në studime Psikosociale nota mesatare vazhdon të jetë mbi 6.5 për shkak të paqartësisë nëse studenti vjen të studiojë jo detyrimisht psikologji, por studime psikosociale.</p>
<p><b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Nga biseda me anëtarë të RVB dhe përgjegjës in e departamentit, dhe dekanin mësohet se informimi i studentëve realizohet përmes faqes online dhe sekretarisë e zyrës së mbështetjes së studentëve për programin e studimit.</p> <p>Vërtetojmë se studentët e programit vlerësojnë pedagogun përkatës në lëndët që ata lektrojnë përmes pyetësorëve të vlerësimit si dhe fokus grupeve dhe ky proces ndodh i koordinuar nga zyra e NJSBCZHK.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe e karrierës janë funksionale dhe i ofrojnë këshillim të vazhdueshëm studentëve përmundësitë e ardhme të punësimit dhe internshipeve. <i>Merak dhe shqetësim për këtë është edhe fakti se një kurrikul e tillë vështirëson apo bën të pamundur aktualisht marrjen e liçensimit të studentëve që do të kenë një nivel studimi akademik në Psikologji kur ata të duan të dalin në tregun e punës dhe të kenë përfunduar edhe një nivel të dytë studimor akademik masteri të specializuar. Studentët ishin në dijeni të këtij ngërçi dhe shprehën shqetësimin e tyre me shpresën e bashkëpunimit të institucionit të UMSH me Urdhërin e Psikologut në RSH për qartësimin e tij.</i></p>
<p><b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Nuk ka të diplomuar në këtë program studimi ende.</p> <p>Sekretaria mësimore regjistron në databazën kryesore të gjitha rekordet e nevojshme për këtë gjë. Gjithë ecuria e procedurave të sekretarisë mësimore paraqitet në rregulloren e brendshme për veprimtarinë e sekretarisë mësimore.</p> <p>Vërtetohet se sekretaria mësimore mban elektronikisht dhe me shkresa të dhënat për numrin e studentëve në hyrje dhe lëvizjet e tyre në vitet akademike.</p>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të studentëve dhe karrierës i ofron studentëve asistencë për zhvillimin e aftësive të tyre në kërkimin e punës, si të shkruajnë një CV, etj. Studentët asistohen nga pedagogë të departamentit për konsultime apo bashkëpunime në pushë shenore të pedagogëve. Oraret janë të përshtatura sipas nevojave të studentëve. Edhe personeli akademik ka kontaktet e studentëve në ngarkim të tij për konsultime.</p>



	Lënda e praktikës në këtë program studimor është nën përgjegjësinë e departamentit dhe stafit efektiv. Lënda e praktikës po zhvillohet për herë të parë këtë semestër dhe përmban vështirësitë e saj në gjetjen e institucioneve përkatëse dhe të përshtatshme për realizimin e saj.
<p><b><u>Konkluzionet e GVJ</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Forma dhe organizimi i mësimdhënies janë të përshtatshme për këtë program studimi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktet rregullatore janë në përputhje me vendimet e rektoratit dhe departamentit përgjegjës.</li> <li>2. Për t'u pranuar në këtë program studimi kandidati plotëson kriteret e legjislacionit në fuqi. Por dallimi i mesatares më të ulët ka ndryshim midis degës psikologji dhe asaj sociologji gjë që nuk qartësohet për këtë program studimi.</li> <li>3. Zyra e sekretarisë mban të dhëna korrekte për studentët në program dhe të transferuarit.</li> <li>4. Zyra e këshillimit funksionon në mënyrë aktive dhe ofron këshillime dhe mbështetje për studentët duke i orientuar ata mbi kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë për zgjedhje të ardhme. Studentët kanë një pedagog tutor me të cilin konsultohen në vijimësi. Shqetësim për këtë pikë të raportit mbetet fakti se një kurrikul e tillë vështirëson apo bën të pamundur aktualisht marrjen e liçensimit të studentëve që do të kenë një nivel studimi akademik në Psikologji kur ata të duan të dalin në tregun e punës dhe të kenë përfunduar edhe një nivel të dytë studimor akademik masteri të specializuar. Rekomandohet bashkëpunimi i institucionit UMSH me Urdhërin e Psikologut në RSH për qartësimin e këtij pozicioni dhe mundësie punësimi.</li> </ol>	

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Fusha e kërkimit shkencor është një pikë me rëndësi të konsiderueshme për UMSH dhe për qendrën Kërkimore Shkencore të institucionit. Kjo është një qendër e re e ngritur kohët e fundit në këtë universitet dhe synon të zhvillojë dhe çojë edhe më tej veprimtarinë shkencore të jetës akademike në këtë institucion. Vlerësohet se personeli akademik ka inkurajim dhe mbështetje të vazhdueshme për të synuar rritjen e kërkimit shkencor. Nga takimet në institucion me Dekanin, Përgjegjës in e Departamenti si dhe pedagogët e programit mësohet se stafi akademik ka nxitje për të ndjekur e zhvilluar botime e studime shkencore, të organizojë konferenca brenda e jashtë vendit.

Aktualisht, puna kërkimore shkencore e studentit realizohet nëpërmjet detyrave të kursit apo edhe përfshirjes së studentëve në disa prej punëve shkencore të pedagogëve. Studentëve i jepet mundësia të prezantohen në lëndët përkatëse me literaturën kryesore në vend për fushën specifike si dhe me botimet e pedagogëve. Institucioni në mënyrë periodike realizon një analizë të brendshme mbi rezultatet e punës shkencore, të cilat pasqyrojnë të dhënat e aktivitetit kërkimor shkencor dhe rekomandime për përmirësim. Institucioni ka bashkëpunim me disa nga IAL-të e tjera në vend për organizimin e konferencave shkencore si Universiteti i Tiranës, Universiteti Aleksandër Moisiu, etj. Institucioni nxit edhe publikimin e punimeve ose projekteve më të mira të studentëve në revistën shkencore të universitetit.






Synimet e stimulimit e nxitjes së kërkimit shkencor prezantohen të jenë të vlerësueshme duke filluar nga rritja e aftësive individuale dhe punës në grup të pedagogëve që lektrojnë në këtë program, në rritjen e nivele të shkencor dhe cilësisë së mësimdhënies në Bsc Studime Psikosociale, e deri në krijimin e lidhjeve ndërkombëtare të UMSH në përgjithësi.

Takimi me pedagogët lektues në program mësohet se disa prej tyre kanë krijuar mundësi bashkëpunimi për konferenca e trajnime të stafit me universitete të tjera si psh Universiteti Aldo Moro, Itali, etj.

Nga takimi me përfaqësues të Qendrës Kërkimore të UMSH mësohet se ajo ka ndërmarrë disa lëvizje të rëndësishme për t'i dhënë kërkimit shkencor një faqe të re dhe vlerësim të nevojshëm. Prej kësaj qendre i kërkohet pedagogut efektiv të mbajë një raport të vazhdueshëm për ndërtimin e syllabusit, investimit të tij në kërkimin shkencor që zhivillon, si dhe ka nxitur ndjeshëm edhe cilësinë e botimeve të artikujve në revistën shkencore të UMSH përmes bordit akademik, peer review për të gjitha botimet si artikuj, ashtu edhe libra apo monografi.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe vlerësimi me pikë të diferencuara për orët e kërkimit shkencor duke i realizuar ato përmes një shkalle hierarkie nga botimet në vend pa ose me faktor impakti e deri në botimet në revista ndërkombëtare me ose pa faktor impakti. Lektorët në këtë mënyrë janë të nxitur në një tjetër formë për të kërkuar fitimin e më shumë pikëve për performancën personale profesionale por edhe për të rritur bashkëpunime të mundshme.

Në planet e kësaj zyre në të ardhmen e afërt mësohet të jetë edhe ngritja e një qendre klinike/psikologjike në mbështetje të programit të studimit Studime Psikosociale.

Pikë e dobët e cila vlerësohet edhe prej vetë përfaqësuesve të qendrës është studimi i tregut të punës meqë ai mbetet një studim vëzhgues dhe analitik dhe jo një studim i mirëfilltë. Një studim i tillë mbetet ende sfidë për UMSH.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor  
Shiko Anekset, Tabelën 14.


### **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

Lidhur me këtë pikë të raportit mund të thuhet se përgjithësisht institucioni ndjek politikën e inkurajimit të vendosjes së marrëdhënieve kombëtare dhe ndërkombëtare, si me institucione të arsimit të lartë, ashtu dhe me institucione të tjera në nivel kombëtar dhe vendor. Stafit akademik është inkurajuar për të përmbyllur detyrimet e ecures akademike sidomos për përmbylljen e gradave shkencore dhe vazhdimësinë e ndjekjes së jetës kërkimore shkencore. Institucioni inkurajont mobilitetin e personelit akademik, si dhe lidhjen me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës. Nga takimet e realizuara me dekanin, përgjegjës të departamentit dhe me stafin akademik mësohet se nxitja e kualifikimit shkencor është përgjithësisht e mbështetur nga institucioni plotësisht ose pjesërisht ekonomikisht për nevojat e avancimit shkencor të stafit. Institucioni mbështet personelin akademik në përfshirjen në projekte kërkimore e shkencore përmes miratimit të lejeve apo edhe financimit të pjesshëm, nxit doktorantët të përfundojnë punët e tyre shkencore jashtë vendit apo edhe mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik në trajnime të ndryshme në universitete e institucione jashtë vendit, si dhe për botime të ndryshme në revista me faktor impakti.

Vlen të përmendet edhe fakti që UMSH përgatit një revistë shkencore me bord shkencor dhe prej EUROMEDITERRANEAN dhe që prej vitit 2010 ka botuar rreth 13 numra të saj.





Qendra e zhvillimit strategjik në UMSH është një qendër e re e ngritur për të çuar edhe më tej punën shkencore dhe akademike të stafit akademik të institucionit duke vendosur edhe disa qëllime afatmesme dhe afatgjata për të realizuar qëllimin kryesor.

Institucioni UMSH ka lidhur marrëshje bashkëpunimi me disa institucione qeveritare me të cilat kryesisht bashkëpunimi konsiston në zhvillimet e programve të përbashkëta, mbështetjen e zbatimit të rezultateve të kërkimeve të përbashkëta, realizimin e veprimtarive të përbashkëta kërkimore-shkencore, etj. Ka marrëveshje me universitete brenda e jashtë vendit me të cilët bashkëpunon kryesisht për shkëmbime eksperiencash, organizime konferencash, trajnimesh apo kurse trajnimesh, shkëmbime studentësh, shkëmbim literature apo personeli akademik, etj. Institucioni ka marrëveshje edhe me një sërë organizatash e biznesesh me karakter juridik apo ekonomik për arsye organizimi praktikash mësimore apo kualifikim e punësim studentësh.

Por në këtë kuadër konstatohet se ka disa mangësi në vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin e praktikave mësimore, specifiku në programin e studimit Bsc Studime psikosociale.

Duhet të vendosen në të ardhmen marrëdhënie që garantojnë realizimin e praktikës mësimore sipas qëllimit të programit. Vlerësohet bashkëpunim i kënaqshëm me institucionet shtetërore dhe organizatat profesionale dhe të komunitetit të biznesit. Vlerësohen mangësi në sigurimin nëpërmjet këtyre marrëveshjeve të realizimit të praktikave profesionale në programin e studimit Studime Psikosociale.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Referohu Tabela 15 Anekset.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

Referohu Tabela 16 Anekset.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Verifikohet nga vizita në institucion se ai është inkurajues i promovimit të kërkimeve shkencore përmes zbatimit të disa qëllimeve kërkimore në departamente të ndryshme. Për këtë arsye institucioni ka të përcaktuara edhe objektivat për fushat e kërkimit. Institucioni ka ngritur disa grupe pune për të çuar përpara disa projekte me interes për fushat e ndryshme të kërkimit në shkencat sociale, humane dhe ekonomike.</p> <p>Nga ana tjetër vihet re edhe shkëmbimi i informacionit mes njësisë dhe personelit për të rritur cilësinë e programit të studimit. Universiteti ka krijuar mekanizma për të lehtësuar realizimet e bashkëpunimeve për të garantuar përfshirjen aktive të stafit të departamentit në mësimdhënie edhe në departamente të tjera. Vihet re edhe një ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësisë në proceset kërkimore dhe mësimore e në çuarjen përpara të tyre.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë</b>	



## **vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**

**Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

**Kriteri 2** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Verifikohen nga vizita në institucion si dhe nga takimet me dekanin e përgjegjës të departamentit, si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion që UMSH ka arritur disa marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucionesh homologe brenda e jashtë vendit si me qendra kërkimore në vendet e Bashkimit evropian, Itali, UK, Francë, etj.

Institucioni përpiket të trajnojë në mënyrë periodike edhe stafin akademik në varësi të nevojave të vendit të punës.

Institucioni vlerësohet të ketë realizuar disa bashkëpunime me aktorë të ndryshëm nga biznesi dhe organizata të ndryshme si ato me fokus shërbimesh sociale si psh Centro Clinico dhe Associazione EMDR Albania, qendra sociale 'Të qëndrojmë së bashku', dhe Bashkia Tiranë për të rritur mundësitë e ofertave të studentëve për praktika e më vonë vende pune.

Sugjerohet të shtohet numri i bashkëpunimeve me institucione të reja publike e jo publike për përfitimin nga studentët për praktika e vende pune më vonë pas diplomimit.

## **Konkluzionet e GVJ**

1. Institucioni ka lidhur një numër të lartë marrëveshjesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Njëkohësisht janë vendosur marrëdhënie me shumë institucione private dhe publike, si dhe organe të pushtetit vendor, të cilat ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të institucionit.
2. Vërtetohet se institucioni synon rritjen e përpjekjeve dhe pasurisë intelektuale e burimeve për zhvillimin e tyre nga një kontekst lokal në një kontekst ndërkombëtar për arsimin e lartë.
3. Qëllimet e UMSH lidhur me strategjinë 2018-2023 lidhen drejtpërdrejt me ndërkombëtarizimin e këtij institucioni në disa nivele si: ndërkombëtarizimi i studentëve, i stafit dhe krijimi i një rrjeti partneritetesh për kërkimin shkencor si dhe programe shkëmbimi të stafeve studentore, lektore dhe kërkimore.

*Gjithësesi, për këtë qëllim sugjerohet edhe rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione lokale për të siguruar e shtuar organizimin e orëve praktike që mbulojnë programin për t'i dhënë më shumë larmishmëri organizimit të praktikave dhe hartimit të bashkëpunimeve të mëpasshme për mundësi punësimi.*





## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### Pika të forta:

1. Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar dhe me eksperiencë profesionale në mësimdhënie.
2. Përmbajtja e programit, e silabuseve dhe literatura bazë dhe e rekomanduar janë në përputhje me nevojat e ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.
3. Programi i studimit plotëson kriteret ligjore në lidhje me politikat e formimit të studentëve.
4. Universiteti Mesdhetar i Tiranës angazhohet në drejtim të ruajtjes së standardeve kombëtare për procesin e mësimdhënies dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik të tij duke e mbështetur vazhdimisht atë në këtë drejtim.
5. Staf i akademik ruan një bashkëpunim të frytshëm me institucione të vendeve antare të BE-së dhe OECD-së.
6. Vlerësohet fakti që institucioni në përgjithësi dhe ky program studimi në veçanti të kërkojë të përmirësojë kurrikulën për ta përshtatur atë sipas nevojave të tregut dhe ligjeve në fuqi.
7. UMSH teknikisht ka hapësira dhe pajisje për të lehtësuar dhe mbështetur realizimin e procesit mësimor.
8. Realizimi i praktikave profesionale arrihet përmes mbështetjes nga bashkëpunimi me institucione partnere, përmes marrëveshjeve specifike.

### Pika të dobëta:

1. Titulli i diplomës që studenti përfiton në përfundimin e studimeve Studime Psikosociale vështirëson antërrësimin e mëvonshëm të tij në Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe fitimin e të drejtës për të ushtruar profesionin.
2. Emërtesa dhe vetë struktura lëndore e planit mësimor të këtij programi studimi e pengojnë studentin e diplomuar në këtë program studimi për t'u licensuar dhe, për rrjedhojë për të ushtruar profesionin si psikolog. Kjo për shkak se "Studimet psikosociale" nuk janë një program Bachelor në fushën e psikologjisë dhe si i tillë bie ndesh me kriteret ligjore që përcaktojnë licensimin si psikolog.
3. Numri i kufizuar i marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë program studimi.
4. Paqartësia e mesatares së pranimit të studentëve në këtë program studimi.



5. Programi i studimit nuk mbështet në një studim të nevojave të tregut të punës për profilin e psikologut.
6. Mobiliteti i studentëve në programe të tjera studimi në IAL brenda vendit mbart vështirësi për shkak të kurrikulës së ofruar.

### **Mundësitë:**

1. Programi i këtij cikli studimi ka mundësi të rishikohet; sidomos të rishikojë titullin e diplomës duke e profilizuar në psikologji (p.sh. Psikologji sociale), si dhe duke rikonsideruar objektivat e vetë programit.
2. Shikohet një mundësi e realizueshme dhe e shfrytëzueshme rishikimi i programit në përputhje me misionin dhe objektivat e programit.
3. Bashkëpunimi me Urdhërin e Psikologut mund të ndihmojë në ndërtimin e pikave të përbashkëta si të domosdoshme mes programit të studimit dhe liçensimit të mundshëm të studentëve të ardhshëm për të plotësuar kriteret e nevojshme për punësimin e profesionistëve si psikologë.
4. Universiteti zotëron marrëveshje bashkëpunimi të rëndësishme me institucione të tjera të arsimit të lartë për të mundësuar realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës.
5. Universiteti Mesdhetar i Tiranës ofron mundësi të ofrojë programe studimi master, për të siguruar vijimësi të studimeve për studentët e diplomuar nga ky program.
6. Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimi me institucione që ofrojnë shërbime psikologjike do të mundësonte që studentët të ishin më të ekspozuar ndaj kërkesave të tregut të punës dhe të orientoheshin më mirë në profilizime të mëtejshme.
7. Ekzistojnë mundësi të mira për të riorganizuar kurrikulën dhe kreditet e lëndëve të specialitetit të psikologjisë, sa më efektivisht brenda normës së lejuar (20% çdo vit akademik).

### **Pengesat:**

1. Konkurrencë e lartë në sektorin e arsimit të lartë, shumë institucione të arsimit të lartë në vendin tonë, fragmentizon numrin e studentëve që duan të ndjekin arsimin e lartë në IAL jo publike.
2. Kurrikulat që ofrojnë universitet e tjera në vendin tonë janë të ndryshme nga ajo e ofruar nga UMSH për programin e studimit Bachelor në Studime Psikosociale, pengon mobilitetin e ndërsjellë të studentëve.
3. Vështirësia e ndryshimit e emërtesës së titullit që studenti merr pas përfundimit të studimeve në programin Bachelor në Studime Psikosociale.





### **Rekomandime:**

1. Institucioni të rishikojë titullin e diplomës më qëllim që ti krijojë studentëve mundësinë e ushtrimit të profesionit të psikologut.
2. Rekomandohet përshtatja e emërtesës dhe strukturës së planit mësimor në mënyrë që ti lejojë studentët e diplomuar në këtë program studimi të licensohen për të ushtruar profesionin e psikologut.
3. Institucioni duhet të bëjë përpjekje për shtimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë program studimi.
4. Të qartësohet mesatarja e pranimit të studentëve për këtë program studimi.
5. Institucioni të ndërmarë një studim tregu për të evidentuar nevojat e trugut të punës në profilin e psikologut.
6. Të rishikohet kurrikula e programit të studimit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi me të mëdha mobiliteti.

### **SUMMARY ANALYSES OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION**

#### **SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION GROUP BY SËOT METHOD (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).**

#### **Strengths:**

1. The academic staff of this study program is qualified and has experience in teaching and in the field of psychology.
2. The content of the program, the syllabuses, even the core and recommended literature are in accordance with the needs of the laës and the actual academic guidelines.
3. The study program meets the legal criteria related to the student-training policies.
4. UMSH is committed to maintaining national standards for the teaching process and continuing qualification of its academic staff by continuously supporting it in this regard.
5. Academic staff maintains fruitful cooperation with the institutions of the EU and the OECD member states.
6. It is estimated that the institution in general and this study program in particular seek continuously to improve the curriculum and to adapt it to actual market needs and laës.
7. UMSH technically has space and equipment needed to facilitate and support the realization of the learning process.
8. Realization of professional practices is achieved through support from cooperation with other partner institutions, through specific agreements.

#### **Weaknesses:**






1. The title of the diploma that the student gains in the end of the Bachelor in Psychosocial Studies obstructs his subsequent membership to the Order of Psychologist in the Republic of Albania and gaining the right to practice the profession in the future in the Albanian context.
2. The nomenclature/title and the subject structure of the curricula itself of this study program hinder the graduate student to be licensed and, consequently, to practice the profession as a psychologist. This is because "Psychosocial studies" are not a Bachelor program in the field of psychology and as such contradict the legal criteria that determine the licensing him as a psychologist in the future.
3. Limited number of cooperation agreements for this study program.
4. The vagueness of the average level for admissions of students in this study program.
5. The study program is not supported by a labour market needs survey/research for the psychologist's profile.
6. Mobility of students in other study programs at HEIs within the country faces some difficulties due to the offered curriculum (psychology and sociology).

#### **Opportunities:**

1. It is possible that the program of this study cycle can be reviewed; especially to review the degree title by profiling it in psychology (eg Social Psychology), as well as to reconsider the objectives of the program itself.
2. It is possible to take in consideration the fact that there exist a feasible and usable option to review the program in accordance with the mission and objectives of the program.
3. Collaboration with the Order of Psychologist can help in building common points as indispensable between the study program and potential licensing of actual students to meet the necessary criteria for being member of this Order as well as to gain the license and be employed as psychologists in the future.
4. The University has important cooperation agreements with other higher education institutions to enable the execution of a proper labour market study and research.
5. The Mediterranean University of Tirana provides the opportunity for further master study programs to ensure continuity of studies for students.
6. Increasing the cooperation agreements with institutions providing psychological services could enable students to be more exposed to labour market demands and better orient themselves to profile their qualifications.
7. There are good opportunities to reorganize the curricula and credits of psychology specialty subjects, and credits of psychology specialty subjects, as effectively within the allowed rate/norm (20% each academic year).

#### **Threats:**






1. The competition in higher education sector, high number of universities in Albania, diffuse the number of students that want to be educated in private universities.
2. The Curricula that is offered in other Albanian universities is different from the one offered from MUA for the study program Bachelor in Psychosocial Studies, which prevents the mobility of students.
3. The difficulty to change the name of the title that the student receives after finishing studies in the program Bachelor in Psychosocial Studies.

**Recommendations:**

1. Institution need to revise the degree title in order to create students the opportunity to practice the psychologist profession.
2. It is recommended the adaptation of teaching plan structure and degree name, in order to allow graduated students in this study program to be licensed to practice the psychologist profession.
3. The institution should make efforts to increase the cooperation agreements for this study program.
4. The institution should clarify the students admission average for this study program.
5. The institution should perform a market study to identify the needs of the work market in the psychologist's profile
6. The institution should review the curriculum of the study program, so that students have greater mobility opportunities.

**External Evaluation Group**

1. Prof.As.Dr. Artemisi Shehu
2. Dr. Silvana Loka





## ANEKS

- Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat.  
Tabela 1

IAL	Fakulteti Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike						
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	11	6	5	3	14		16
Departamenti i Shkencave Politike	10	6	2	1	14		12
Departamenti i Administratës Publike dhe i Formimit Bazë	7	3			14		7
Në total	28	15	7	4	42	0	77

- Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamente.  
Tabelat 2

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike							
Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë							
Viti akademik 2018-2019							
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Përparim Kabo	Dekan	Prof. Asoc. Dr.	1	Mirela Lika	Prof. Dr	UT, Fakulteti i Shkencave të Natyrës
2	Inis Shkreli	Përgjegjës Departamenti	PhD	2	Valbona Habili	Dr.	UT, Fakulteti i Shkencave Sociale
3	Mimoza Ahmeti	Lektore	PhD	3	Zana Strazimiri	Dr.	UT, Fakulteti i Shkencave Sociale
4	Arjeta Veshi	Lektore	PhD	4	Nora Malaj	Proces. Dr.	Kuvendi i Shqipërisë
5	Ilda Kashami	Lektore/Asisten te Ekzekutive	PhD	5	Desdemona Çelo	Msc.	UT, Fakulteti i Shkencave Sociale
6	Klodiana Rafti	Lektore	Dr.				
7	Ela Tollkuçi	Lektore /Drejtuese teknike për	Proces. Dr				






		punën shkencore					
